



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri,
dhe mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr.1
Prishtinë, më 22 Mars 2011
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe
mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ibrahim Makolli dhe Rasim Demiri- anëtarë të komisionit.

Mungoi: Fatmir Xhelili- anëtarë të komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Ceku, Blerina Pula, Antigona Ibraj, Haxhi Xhemali.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Konstituimi i Komisionit
3. Miratimi i fushëveprimit të Komisionit
4. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Konstituimi i Komisionit

Ahmet Isufi - Është takimi i parë konstituiv i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri, dhe Mbikëqyrjen Forcave të Sigurisë së Kosovës. Të gjithëve urime për përzgjedhje në këtë komision, dhe dua të ju ofroj bashkëpunimin tim të plotë. Unë jam Ahmet Isufi, deputet i grupit parlamentar të AAK-së. Ju kisha lut që të prezantoheni secili, në mënyrë që të njihemi.

Rexhep Selimi - Rexhep Selimi nga Lëvizja Vetëvendosje, dhe njëkohësisht jam Nënkryetar i Komisionit për Siguri.

Ganimete Musliu - Unë jam Ganimete Musliu nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Goran Marinković - Unë jam Goran Marinković nga SLS

Rasim Demiri - Unë jam Rasim Demiri nga Grupi Parlamentar 6+

Ibrahim Makolli - Ibrahim Makolli nga Grupi Parlamentar i AKR-së

Vjollca Krasniqi - Vjollca Krasniqi prej Lidhjes Demokratike të Kosovës

Anton Quni - Anton Quni nga Grupi Parlamentar i LDK-së

3. Fushëveprimi i Komisionit

Në piken e tretë e keni Fushëveprimin e Komisionit. A dëshironi ta lexojmë apo le të jetë kjo më shumë mbledhje solemne, e javën tjetër e aprovojmë sepse e shikoni gjatë javës, mund të plotësoni diçka, të shtoni diçka dhe javën tjetër e kishim aprovu. Ju e keni marrë një raport të punës, të mandatit të kaluar 2008-2010 të Komisionit të mëhershëm. Më herët Komisioni është kryesuar nga Rustem Mustafa, dhe e falenderoj për punën që e ka bërë ky Komision. Ne do të mundohemi që në bazën që e ka kriju më heret komisioni veq ta ngrisim edhe më lartë. Kjo për shkak se tani kemi edhe një fuzionim të një veprimi shtesë që është mbikqyrja e Forcave të Sigurisë së Kosovës, dhe duhet të jemi shumë më veprues. Në bazë të rregullores së punës së Kuvendit, mbledhjet janë të parapara së paku dy në muaj, unë propozoj ti kemi katër, për shkak të gjendjes së sigurisë në Kosovë. Bashkëpunim të drejtpërdrejtë kemi me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Komisioni ka njësinë mbështetëse të Administratës të cilët

janë për të na dhënë këshilla ligjore dhe procedurale. Po ashtu mbështetet edhe nga organizatat ndërkombëtare me Këshilltarë që janë: Nuredin Ibishi nga UNDP, Blerina Pula nga DICAF, dhe Afrim Hoti nga KFOS. Unë nuk dua ta ngarkojë këtë mbledhje më shumë, sepse desha të ketë më shumë kuptimin konstituiv dhe solemn. Ju kisha lut juve anëtarve të Komisionit nëse keni diqka.

Rexhep Selimi - Pasi është takimi i parë konstituiv, rrjedhimisht vjen thirrje për bashkëpunim, për punë si ekip, për kordinim dhe konstruktivitet. Me që u përmend mbikëqyrja e shumë ligjeve, unë kisha propozuar ekipit dhe kryetarit që pavarësisht dy takimeve në muaj, gjithsesi të mbahen katër takime në muaj sepse ky komision kërkon shumë punë. Mendoj që duhet të shpërndahen përgjegjësitë, të ndahen fushëveprimet e anëtarve veç e veç.

Ganimete Musliu - Më vjen mirë që po takohemi në këtë mbledhje konstituive të Komisionit. Gjithsesi pajtohem me parafolësit që është e nevojshme të mbahet çdo javë mbledhjet e Komisionit. Gjithsesi kisha një kërkesë nga punëtorët e Administratës. Mundësisht materialet të na dërgohen përmes e-mail, për shkak të rritjes së efikasitetit dhe përgjegjësisë sonë.

Goran Marinković – Në periudhat e ardhshme besoj që do të jemi më mirë të informuar për të gjitha rrjedhat në komision. Pajtohem me parafolësen se është e rëndësishme të merret materiali më herët. Besoj se do të japim kontributin tonë në këtë komision, dhe sa i përket mbledhjeve të komisionit, është më mirë të kemi dy mbledhje efektive.

Rasim Demiri – Mendoj që ky komision është i rëndësishëm për shoqërinë kosovare. Si përfaqësues i Grupit Parlamentar 6+ besoj se do të japim kontributin tonë, që do të jetë në të mirë të shoqërisë kosovare.

Ibrahim Makolli: Unë mendoj që duhet të ketë dy mbledhje të rregullta mujore të Komisionit, dhe këtu të pajtohemi për të mos pasur pastaj lëvizje. Do të kemi rastin të takohemi dy-tri herë në javë atëherë kur do të ketë një numër të madh ligjesh që do të procedohen, sfidat e raportit të progresit. Është mirë që ti kemi mbledhjet çdo të Martë, në orën 13:00, për shkak se ma herët është mbledhja e Kryesisë së Kuvendit. Duhet të ketë edhe një plan veprimi dhe menaxhim të punës tonë që do ta kemi.

Vjollca Krasniqi - Fuzionimi i këtyre Komisioneve do ta shtoj volumin e punës në këtë Komision. Për mua si anëtare e këtij Komisioni dhe si deputete e re në Parlament, do të jetë edhe një lëmi të cilën më heret nuk kemi pas mundësi ta trajtojmë në kësi forme dhe do të mundohemi që ky komision të jetë funksional. Pajtohem që materiali të dërgohet me e-mail, sepse mungesa e zyreve në Kuvend po e bën të pamundur që të jemi këtu.

Anton Quni - Besoj se të gjithë anëtarët e këtij Komisioni, me përvojën, ekspertizën, do të arrijmë që me përgjigjesi të lartë, ti përgjigjemi elektoratit, institucioneve, shoqërisë. Një kërkesë kisha pas ndaj punëtorëve të Administratës, që këto të dhëna që po i dorëzojmë tu shkëmbehen të gjithëve, që të jemi korrekt.

Ahmet Isufi – Unë i kam parasysh propozimet e dhëna në këtë mbledhje. I analizojmë gjatë javës, dhe në takimin e ardhshëm, të kemi propozime konkrete ku marrim edhe vendime si komision. Kërkoj nga ju se pavarësisht nga cili subjekt politik vijmë, këtu më së shumti përfaqësojmë interesat e qytetarëve të Kosovës, interesat e Parlamentit të Kosovës, në Komisione bëhen ligjet të cilat janë në dobi të përbashkët. Kam dëshirë që këtu të punojmë si Komision parlamentar si ekip i përbashkët dhe pa asnjë dallim, ndërsa çështjet dhe reflektimet politike i paraqesim në Kuvend,

Pasi nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi